



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. Prot / 2050 /2026

THIRRJE PUBLIK

Për përfaqësues nga shoqëria civile për anëtar të Komisionit për Ndarjen e Bursave për vitin akademik 2025/2026.

DKA, shpall:

Thirrje publike për përfaqësues nga shoqëria civile për t'u bërë pjesë e Komisionit për vlerësimin dhe ndarjen e bursave komunale për studentë për vitin akademik 2025/2026.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të marrë pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për bursa;
- Të kontribuojë në procesin e vendimmarrjes në mënyrë të paanshme dhe profesionale;
- Të respektojë kriteret e përcaktuara dhe parimet e transparencës dhe konfidencialitetit.

Kriteret për aplikim:

- Të jetë përfaqësues i një organizate të shoqërisë civile aktive në Komunën e Hanit të Elezit;
- Të ketë integritet profesional dhe etik;
- Përvoja në fushën e arsimit, rinisë, çështjeve sociale ose projekteve komunitare përbën përparësi;
- Të mos jetë në konflikt interesi me procesin e ndarjes së bursave.

Dokumentet e nevojshme:

- CV e aplikantit;
- Dëshmi për përfaqësimin e organizatës së shoqërisë civile.

Afati i aplikimit:

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 5 (pesë) ditë kalendarike nga 02.03.2026 deri më 06.03.2026

Mënyra e aplikimit:

Aplikimet mund të dorëzohen:

Qendra për shërbime me qytetar në Komunën e Hanit të Elezit,

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen nga ana e DKA-së.

Komuna e Hanit të Elezit inkurajon të gjitha organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë në këtë proces të rëndësishëm për mbështetjen e studentëve.

Drejtori për Arsim

Komuna e Hanit të Elezit

Hisni Luri

